**Shtëpia Botuese ALBTIPOGRAFIA & SHBLSH E RE**

**Plani mësimor: Edukimi për karrierën, klasa e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë arsimi parauniversitar**

Plani mësimor është i bazuar në kurrikulën e miratuar nga MASH

Kurrikula është zbatuar plotësisht, plani mësimor përputhet në çdo orë me të.

Struktura e librit realizon: temat mësimore teorike (njohuri të reja), veprimtaritë praktike, testet dhe përsëritjet.

Libri ka objektivat kryesore për çdo linjë dhe për çdo temë mësimore.

| KLASA 11 | | | |
|---|---|---|---|
| **LINJA 1**<br>**HULUMTIMI I KARRIERËS**<br>**(18 orë)** | | | **Objektiva të Përgjithshëm**<br>1) Të aftësohet për të hulumtuar në botën e punës.<br>2) Të dallojë kualifikimin si një parakusht për arritjen e një vendimmarrjeje të studiuar mirë.<br>3) Të investigojë karriera të suksesshme në tregun e punës. |
| | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva** |
| 1 | Puna, profesioni, karriera | **1** | • Të dallojë konceptet punë, profesion, karrierë.<br>• Të kuptojë rëndësinë e kualifikimit të vazhdueshëm.<br>• Të njohë sistemin formal dhe joformal të kualifikimit në Shqipëri. |
| **2** | Legjislacioni i punës në Republikën e Shqipërisë. | **1** | • Të njohë legjislacionin e punës në Shqipëri.<br>• Të dallojë shembuj të zbatimit të legjislacionit të punës. |
| **3** | Siguria dhe shëndeti në punë. | **1** | • Të shpjegojë rëndësinë e rregullave të sigurimit në punë<br>• Të dallojë raste të sëmundjeve profesionale e të aksidentevenë punë. |
| **4** | Tregu i punës dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij. | **1** | • Të dallojë tregun e punës dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij.<br>• Të identifikojë forma të veprimtarive të ndryshme në tregun e punës. |
| **5** | Prirjet e zhvillimit të tregut të punës dhe burimet kryesore të punësimit. | **1** | • Të dallojë prirjet e zhvillimit të tregut të punës. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | • Të përcaktojë burimet kryesore të punësimit në tregun lokal, kombëtar e ndërkombëtar.<br>• Të përshkruajë rolin e shtetit në zhvillimin e tregut të punës. |
| | Kontrata e punës.<br>**Veprimtari praktike**.( Material plotësues) | **1** | • Të dallojë elementet e kontratës individuale të punës.<br>• Të plotësojë një kontratë pune individuale. |
| **6** | Punësimi dhe shërbimet sociale në tregun lokal. | **1** | • Të dallojë statuset e individëve në tregun e punës: i punësuar, i papunë, student, si dhe veçoritë e tyre<br>• Të përshkruajë shërbimet kryesore sociale. |
| **7** | Shërbimet e ndihmës sociale, të papunësisë, dhe programet e formimit profesional në tregun lokal.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të dallojë shërbimet sociale, format e ndihmës dhe programet e formimit profesional që ofrohen në zonë/rajon.<br>• Të përpunojë në formë tabelash, grafikësh dhe të analizojë të dhënat konkrete. |
| **8** | Profesione të prodhimit dhe shërbimit në tregun lokal. | **1** | • Të dallojë veprimtaritë e shërbimit nga ato të prodhimit.<br>• Të rendisë faktorët që përcaktojnë zhvillimet ekonomike në tregun lokal. |
| **9** | Ndikimim i profesioneve në organizimin e jetës. | **1** | • Të argumentojë ndryshimet midis veprimtarive të ndryshme të punës.<br>• Të paraqesë përvoja nga pjesëtarët e familjes në lidhje me ndikimin e profesionit në mënyrën e jetesës<br>• Të dallojë profesione të ndryshme |
| **10** | Forma të ndryshme të punës.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të dallojë forma të ndryshme të punës.<br>• Të kuptojë rëndësinë e formave te punës, në zhvillimin e karrierës.<br>• Të dallojë ndryshimin midis shkollës dhe punës. |
| **11** | Si të kërkoj punë | **1** | • Të dallohen metodat dhe mjetet e të kërkuarit punë.<br>• Të interpretohen informacionet nga burime të ndryshme për punë.<br>• Të praktikohet konkretisht kërkimi i punës. |
| 12 | Njohuritë, shprehitë e punës dhe burimet e vendeve të lira të punës. | **1** | • Të dallojë njohuritë, shprehitë, qendrimet në punë.<br>• Të vlerësojë shembuj konkretë të njohurive, shprehive, qendrimeve në punë.<br>• Të identifikojë burimet dhe mënyrat e ofrimit të vendeve të lira të punës. |
| **13** | Investigimi i karrierave të ndryshme në tregun e punës. | **1** | • Të paraqesë instrumentet e investigimit të karrierave të suksesshme.<br>• Të listojë profesione të investiguara nga tregu i punës. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **14** | Faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e profesioneve. | **1** | • Të paraqesë preferencat për profesione të caktuara<br>• Të argumentojë përzgjedhjen e profesioneve të preferuara |
| **15** | Qëndrimet ndaj profesionit të zgjedhur dhe nevojat e vazhdueshme për kualifikim. | **1** | • Të kuptojë nevojën e lidhjes së profesionit të dëshiruar me qëndrimin e duhur ndaj punës.<br>• Të dallojë njohuritë, shprehitë, qendrimet dhe kualifikimet në profesionin e zgjedhur. |
| **16** | Ndikimi i përvojës dhe trajnimit në karrierë.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të identifikojë në praktikë ndikime të përvojës dhe trajnimeve në punë dhe karrierë.<br>• Të kuptojë nevojën e domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm si burim suksesi. |
| **17** | **Përsëritje** | **1** | |
| **18** | **Test** | **1** | |
| **LINJA 2**<br>**VETËVLERËSIMI**<br>**(8 orë)** | | | **Objektiva**<br>**1)**Të gjykojë dhe përgatisë informacionin për vetveten, duke marrë parasysh edhe ndikimet e mjedisit.<br>**2)**Të identifikojë interesat dhe dëshirat personale në lidhje me profesione të ndryshme.<br>**3)** Të vlerësojë shëndetin personal në lidhje më profesionet e përzgjedhura.<br>**4)** Të listojë tiparet personale për të patur karrierë të suksesshme në profesione të përzgjedhura. |
| | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva** |
| **19** | Interesat, dëshirat personale për profesione të ndryshme. | **1** | • Të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme.<br>• Të dallojë mundësitë për profesione të ndryshme. |
| **20** | Ndikimi i interesave personale në përzgjedhjen e profesionit. | **1** | • Të bëjë vetëvlerësimin sipas dëshirave e interesave që lidhen me profesione të ndryshme.<br>• Të vlerësojë/rivlerësojë aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme në lidhje me profesionin e përzgjedhur. |
| **21** | Vlerësimi i shëndetit personal. | **1** | • Të vlerësojë shëndetin personal në raport me profesionin e zgjedhur.<br>• Të dallojë ndikimin negativ të alkoolit, barnave, duhanit, drogës etj. |
| **22** | Probleme të seksualitetit dhe dallimeve gjinore. | **1** | • Të dallojë konceptet seksualitet, sensualitet, intimitet, dallime gjinore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | • Të kuptojë rolin e tyre në marrëdhëniet sociale dhe në punë.<br>• Të dallojë forma të diskriminimit gjinor. |
| 23 | Identifikimi i aspekteve të sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në profesione të ndryshme.<br>**Veprimtari praktike** | 1 | • Të dallojë sensualitetin, intimitetin nga seksualiteti dhe dallimi gjinor.<br>• Të identifikojë shembuj të këtyre shfaqjeve në profesione të ndryshme.<br>• Të vlerësojë shkallën e shfaqjes së tyre. |
| 24 | Faktorët që ndikojnë në karriera të suksesshme. | 1 | • Të identifikojë tipare, faktorë që ndikojnë në karriera të suksesshme.<br>• Të shpjegojë si ndikojnë stresi, konfliktet, menaxhimi i kohës, mënyrat e komunikimit në suksesin në karrierë. |
| 25 | Roli i tipareve personale në karrierë.<br>**Veprimtari praktike** | 1 | •Të njohë disa paragjykime për profesionet dhe të kuptojë qëndrimin objektiv ndaj profesionit.<br>• Të identifikojë tiparet personale që krijojnë mundësi suksesi në punë. |
| 26 | **Test** | 1 | |
| **LINJA 3**<br>**PLANIFIKIMI/ VENDIMARRJA PËR KARRIERËN**<br>**(10 orë)** | | | **Objektiva**<br>**1)** Të aftësohet të hartojë planet për të ardhmen.<br>**2)** Të përshtatë planet për të udhëhequr ndryshimin dhe tranzicionin.<br>**3)** Të plotësojë portofolin për karrierën. |
| | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva** |
| 27 | Përgatitja e Curriculum Vitae | 1 | • Të hartojë një Curriculum Vitae sipas elementeve të duhur.<br>• Të dallojë rubrikat e Curriculum- it, duke vënë në dukje aftësitë, cilësitë personale, informacione të tjera. |
| 28 | Letra e shoqërimit. Forma aplikimi.<br>Veprimtari praktike. | 1 | •Të hartojë letrën e shoqërimit.<br>•Të plotësojë forma të gatshme aplikimi për punë.<br>•Të hartojë një "curiculum vitae" sipas formave të qarta duke vënë në dukje (me formë imagjinare), aftësitë, cilësitë personale. |
| 29 | Intervista e punësimit dhe llojet e saj | 1 | • Të dallojë rëndësinë e intervistës së punësimit.<br>• Të shpjegojë llojet e intervistave për punë.<br>• Të paraqesë procesin e parapërgatitjes për intervistë. |
| 30 | Përgatitja për intervistë.<br>**Veprimtari praktike** | 1 | • Të demonstrojë një rast të simuluar interviste.<br>• Të paraqesë rregulla të komunikimit dhe etikës gjatë intervistës. |
| 31 | Planifikimi i karrierës | 1 | • Të shpjegojë procesin e planifikimit të karrierës.<br>• Të hartojë qëllimin dhe objektivat për karrierën.<br>• Të shpjegojë procesin e vendimmarrjes për karrierën. |
| 32 | Planifikimi i objektivave për karrierë | 1 | • Të përcaktojë objektiva për karrierën.<br>• Të planifikojë afatet kohore për çdo objektiv. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | • Të dallojë elemetet e buxhetit personal lidhur me karrierën. |
| **33** | Hartimi i buxhetit familjar ose personal.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të dallojë konceptet shpenzime, të ardhura, rezultat buxheti.<br>• Të hartojë buxhetin familjar ose personal. |
| **34** | Elemente të portofolit të karrierës | **1** | • Të planifikojë strategjitë për karrierën personale.<br>• Të listojë elementet përbërës të portofolit për karrierën.<br>• Të plotësojë portofolin për karrierën sipas rubrikave. |
| **35** | **Përsëritje** | **1** | |
| **36** | **Test** | **1** | |
| **KLASA 12** | | | |
| **LINJA 4**<br>**HULUMTIMI I SIPËRMARRJES**<br>**(6 orë)** | | | **Objektiva**<br>**1)** Të identifikojë përvoja për mënyra të hapjes dhe mbajtjes së një sipërmarrje.<br>**2)**Të dallojë cilësitë dhe aftësitë e personave sipërmarrës.<br>**3)** Të vlerësojë rëndësinë e arsimit dhe trajnimit në zhvillimin e një sipërmarrje. |
| | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva** |
| **37** | Roli i sipërmarrësit në suksesin e aktivitetit të tij | **1** | • Të kuptojë rëndësinë e iniciativës vetjake në sipërmarrje.<br>• Të dallojë disa cilësi dhe aftësi të domosdoshme të personit sipërmarrës. |
| **38** | Sipërmarrje në familje dhe në komunitet | **1** | • Të njohë si ndërtohet një sipërmarrje, në familje ose komunitet.<br>• Të hetojë ndërtimin e një sipërmarrjeje. |
| **39** | Përvoja të hapjes dhe fuqizimit të sipërmarrjeve të ndryshme të zonës<br>**Veprimtari praktike në terren** | **1** | • Të hetojë sipërmarrje të formave të ndryshme të zonës.<br>• Të njohë përvoja të hapjes dhe fuqizimit të sipërmarrjeve. |
| **40** | Veçori të sipërmarrjes sipas produktit, shërbimit, tregut, forcave të punës | **1** | • Të njohë forma të ndryshme sipërmarrjesh.<br>• Të dallojë veçoritë që karakterizojnë sipërmarrjet sipas produktit, shërbimit, tregut, forcave të punës. |
| **41** | Përvoja të disa sipërmarrjeve private.<br>**Veprimtari Praktike** | **1** | • Të mësojë ndërtimin e një raporti lidhur me sipërmarrjet private.<br>• Të aftësojë nxënësit në prezantimin e një raporti. |
| **42** | Rëndësia e arsimimit dhe e trajnimit për zhvillimin e sipërmarrjes. | **1** | • Të kuptojë nevojën e arsimimit dhe trajnimit fillestar e në vazhdimësi.<br>• Të identifikojë nevojat për trajnim në zhvillimin e një sipërmarrjeje. |

| LINJA 5<br>**VETËVLERËSIMI PËR SIPËRMARRJEN (4 orë)** | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva**<br>**1)**Të argumentojë gjykimin personal në lidhje me aftësitë sipërmarrëse.<br>**2)**Të identifikojë mundësitë personale për realizimin e një veprimtarie sipërmarrëse |
|---|---|---|---|
| **43** | Cilësitë personale lidhur me aftësinë sipërmarrëse. | **1** | • Të dallojë cilësitë e domosdoshme për një sipërmarrje.<br>• Të identifikojë anët e forta dhe të dobëta që ndikojnë në aftësitë sipërmarrëse. |
| **44** | Forca gjykuese dhe logjika e ftohtë në një aktivitet sipërmarrës. | **1** | • Të dallojë faktorin njeri në suksesin e sipërmarrjes.<br>• Të argumentojë fuqinë gjykuese personale lidhur me një aktivitet sipërmarrës. |
| **45** | Trajnimet për zhvillimin e aftësive personale sipërmarrëse.. | **1** | • Të kuptojë trajnimin personal si një nevojë të domosdoshme.<br>• Të vetvlerësojë konkretisht nevojat për trajnime. |
| **46** | Identifikimi i mundësive personale për të filluar një sipërmarrje.<br>**Veprimtari Praktike** | **1** | • Të bëhet një vetvlerësim i mundësive personale për të hapur një sipërmarrje.<br>• Të marrë pjesë aktive në veprimtarinë praktike. |
| **LINJA 6**<br>**PLANIFIKIMI/VENDI MARRJA PËR SIPËRMARRJEN (8 orë)** | | | **Objektiva**<br>**1)** Të aftësohet në hartimin e planeve për të udhëhequr ndryshimin dhe tranzicionin.<br>**2)**Të vlerësojë përdorimin e informacionit dhe teknologjive në një sipërmarrje biznesi.<br>**3)**Të identifikojë cilësi të personave të suksesshëm në sipërmarrje. |
| | **TITULLI I MËSIMIT** | **Orë mësimi** | **Objektiva** |
| **47** | Zhvillimi i aftësive sipërmarrëse. | **1** | • Të kuptojë çfarë është një sipërmarrje/ndërmarrje.<br>• Të dallojë ngjashmërinë dhe ndryshimet e sipërmarrjeve.<br>• Të kuptojë rëndësinë e klasifikimit të sipërmarrjeve. |
| **48** | Burimet e nevojshme për një sipërmarrje. | **1** | • Të dallojë burimet e nevojshme për një sipërmarrje.<br>• Të identifikojë faktorët e tregut që ndikojnë në mirëfunksionimin e sipërmarrjes/biznesit. |
| **49** | Plani strategjik i një vizite në një biznes.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të përcaktojë qëllimin kryesor të planit strategjik. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **50** | Vizitë në një biznes lokal.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të krijojë një vizion të qartë për funksionimin e një biznesi.<br>• Të organizojë një vizitë në një biznes lokal. |
| 51 | Njerëz të sukseshëm në biznese të ndryshme.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të njohin histori të ndryshme për njerëz të famshëm në drejtim të sipërmarrjes.<br>• Të krahasojnë historitë e secilit dhe të analizojmë cilësitë e tyre të përbashkëta.<br>• Nëpërmjet punës në grup, të identifikojnë cilësitë e tyre sipërmarrëse, që i bënë ata njerëz të famshëm. |
| **52** | Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit në një sipërmarrje.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të vlerësojë rëndësinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në një sipërmarrje biznesi.<br>• Të kuptojë rëndësinë e investimit për përdorimin e kësaj teknologjie. |
| **53** | Menaxhimi i një takimi me një sipërmarrës/e.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të mësojë për menaxhimin e një takimi.<br>• Të sensibilohen sipërmarrës/e të ndryshëm, për rëndësinë që merr në ditët e sotme transmetimi i eksperienacve të tyre për brezin e ri.<br>• Të menaxhojë takimin duke e konsideruar atë si një bashkëbisedim. |
| **54** | Gjërat që ju mund të bëni.<br>**Veprimtari praktike** | **1** | • Të ndërmarrë rol udhëheqës në grup në një veprimtari konkrete.<br>• Të planifikojë dhe të organizojë një mbledhje.<br>• Të paraqesë një detyrë konkrete në komunitet.<br>• Të bëjë vlerësimin feed (back-un) e veprimtarive të kryera (sukseset e arritura dhe vështirësitë e ndeshura). |